



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:193183  
Datë: 28.02.2024  
Numri i dokumentit: 05389646

**P.nr. 715/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.G...me vendbanim në Gj..., Rr."A...",nr.71, me mbrojtësin sips detyrës zyrtare av. Elbasan Alidema nga Gjilani, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur e paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr. 1359/2023 të datës 05.10.2023, të cilën e përfaqëson prokurori Adnan Hajdari pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 14.02.2024 mori dhe shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri M.G..., i biri i S. dhe nënës M..., e gjinisë G..., i lindur më ..., në fshatin D...-Komuna e K..., me numër ..., me vendbanim Gjilan, Rr."A...", të kryer shkollën e mesme, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike, I martuar, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale ndaj tij.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 14.08.2023, rreth orës 12:00, në rrugën e M..., afër kryqëzimit me rrugën "...", përkatësisht në vend parkimin e rezervuar për Taxi, i pandehuri nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës "Ford Focus", ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit 06-479-BB, ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, me ç'rast i njejt fillon të lëvizë mbrapa me qëllim të hyrjes në trafik nga vend parkimi pa u bindur se, një veprim i tillë nuk i pengon ose nuk i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ku me pjesën e pasme të automjetit e godet në këmbën e majtë këmbësoren tani të dëmtuaren Safete Kerçeli, e cila ishte duke ecur skaj rrugës e cila si pasojë e kësaj goditje nga lëshimet e lartpërmendura të të pandehurit, pëson lëndime trupore të cilat paraqesin lëndime të rënda trupore, në formë të ndrydhjeve (mbretje) të indeve të buta të regjionit të kërdhokullës të kofshës dhe gjurit të majtë, çarje të bririt të përparmë dhe të pasmë të meniskusit (ligamentit) të mesëm të gjurit të këmbës së majtë dhe krisje( plasaritje) të kondyllusit të jashtëm të kockës së nëngjurit (tibisë) të këmbës së majtë, të shkaktuara nga veprimi i mjetit të forte mbretës (jo i mprehtë, i topitur), e cila për shkak të natyrës së lëndimeve është trajtuar fillimisht në Emergjencë e më pastaj në repartin e Ortopedisë - Spitalin Regjional në Gjilan, -me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 46, 47, 48, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurin:

## E GJYKON

**I.** Të pandehurit M.G...për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, i caktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë penale.

**II.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

**III.** Obligohet i akuzuari që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumën prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**IV.** Obligohet i pandehuri M.G...që të paguajë shpenzimet për ekspertizën e Komunikacionit shumën prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), dhe shpenzimet për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### **1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 05.10.2023, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1359/2023, ndaj ndaj të pandehurit M.G...për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 14.02.2024, prezent ish-in prokurori i shtetit Adnan Hajdari, i pandehuri M.G...dhe mbrojtësi i tij Elbasan Alidema, avokat nga Gjilani i caktuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa nuk ka prezentuar e dëmtuara S. K..., për të cilën në fletëdorëzim është konstatuar se e njejta gjindet në Kanadë, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale.

### **2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit të dëmtuarit dhe mbrojtësit të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit M.G..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### **3. Gjendja faktike e vërtetuar**

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë penale, ekziston fakti se i pandehuri M.G...ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s, dhe ka shkelur nenin 53 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor të Kosovës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **4. Elementet e veprës penale**

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pandehuri M.G...ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-s dhe ka shkelur nenin 53 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor të Kosovës, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

**5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim me kusht, ngase duke i marrë parasysht të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, i pandehuri ka shprehur keqardhje dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarës dhe familjes së saj, i pandehuri më parë nuk ka kryer vepra të tjera penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do të ketë më tepër kujdes gjatë drejtimit të automjetit dhe nuk do të drejtoj traktorin pa patent shofer dhe nuk do të kryejë vepra të ngjajshme dhe të tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese ka marrë lëndimin trupor të dëmtuarës, rrezikshmërinë shoqërore dhe përgjegjësinë penale të pandehurit.

**6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit M.G..., është i lidhur me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**7. Vendimi për kërkesën pasurore-juridike**

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

**8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e obligoi të pandehurin M.G...që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit, shpenzimet për ekspertizën së komunikacionit dhe ekspertizës mjeko-ligjore si dhe shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr. 715/2023, Me datë 14.02.2023**

**Sekretarja Juridike**

Fatmire Sermaxhaj d.v

**Gjyqtari**

Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE;** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të Përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.